



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

WORLD UNIVERSITY SERVICE OFRON BURSA PËR STUDENTËT NË SHQIPËRI

University World Service (WUS), është një organizatë ndërkombëtare që operon si një komunitet studentësh, mësuesish dhe të punësuarish në sektorin e arsimit. WUS ofron 50 bursa studimi për studentët shqiptarë të universiteteve shtetërore shqiptare për të studiuar në Shqipëri për vitin akademik 2017-2018.

Qëllimi i këtij programi është të lehtësojë elitën e arsimuar shqiptare dhe të punësuarit e rinj të kualifikuar në Shqipëri, për zhvillimin e perspektivës profesionale në të ardhmen. Këto bursa i adresohen studentëve të universiteteve publike shqiptare në fazën përfundimtare të studimeve të tyre (master) dhe/ose që pritet të diplomohen përgjatë vitit akademik 2017-2018, që kanë përfunduar studimet prej jo më shumë se 6 muajsh, kanë një ide biznesi (start-up) ose dëshirojnë të kryejnë një praktikë. Për aplikantët me të ardhura të pakta familjare do të aplikohen kritere preferenciale.

Përveç një burse mujore prej 250,00 €, studentët apo ata që janë në fillimet e karrierës do të përfitojnë këshillime dhe trajnime për teknikat e aplikimit, sipërmarrjen, karrierën dhe për ofertat e praktikave të punës. Gjatë periudhës maksimale 6-mujore të bursës, studentët, në varësi të llojit të bursës, do të marrin pjesë në trajnime për aplikim për punë si dhe për të filluar një biznes të ri (trajnime individuale dhe në grupe). Ky projekt të realizohet me mbështetjen financiare të Ministrisë së Ekonomisë, Energjisë, Transportit dhe Zhvillimit Rajonal në Hessen.

Trajnimet do të bëhen sipas universiteteve në rrethe në datat dhe ambientet si më poshtë:

Vlorë - 4 Qershor 2017, - Hotel "Pavarësia";

Korçë - 15 Qershor 2017, - Hotel "Konti" ;

Shkodër - 29 Qershor 2017, - Hotel „Tradita“;

Tiranë, Durrës dhe Elbasan - 6 Korrik 2017 dhe 13 Korrik 2017, - Tirana Business Park;

Gjirokastrë - 9 Korrik 2017, - Hotel "Çajupi";

Afati i aplikimit për studentët e Universitetit të Vlorës, Korçës and Shkodrës është **1 javë** para fillimit të trajnimit dhe afati i aplikimit për studentët e Universitetit të Gjirokastrës, Tiranës, Durrësit dhe Elbasanit është **10 ditë** përpara fillimit të trajnimit, (pjesëmarrja është e kufizuar deri në 30 studentë). **Studentët që nuk marrin pjesë në trajnim nuk kanë të drejtë të aplikojnë për bursë.**

Informacione të mëtejshme si dhe formularët e aplikimit, i gjeni në adresën www.surplace-albania.de, albania@wusgermany.de ose direkt nëpërmjet Znj. Eda Terezi, Terezi@wusgermany.de - Koordinatorë e Projektit për Shqipërinë.